



# Jeta Liturgjike

Viti I Nr. 11, Dhjetor 2005

A detailed photograph of a nativity scene. In the center, a woman (Mary) is kneeling on the left, holding a small infant (Jesus) wrapped in swaddling clothes. To her right, a man (Joseph) stands, looking down at the child. A single lit candle stands between them, casting a warm glow. The scene is set within a dark, rustic-looking structure, possibly a stable, with green pine branches visible at the top and bottom. The overall lighting is soft and focused on the figures.

Për Shumë Mot Kërshëndellat!

# *Për shumë mot K ërshendellat*

Gëzimi është shprehje e zgjidhur e jetës. Gëzimi është dasma e shpirtit. Gëzimi është ngazëllim i lumturisë dhe buzëqeshje qëndrese e fatit. Gëzimi është shpeshherë lindje e gjatë. Zgjohet nga pikëllimi dhe nevoja, ndërsa forcohet nga lotët. Gëzimi dëshiron që të shpërndahet dhe të dhurohet. Gëzimi nuk rri brenda. Gëzimi tejkalon vendet dhe kufijtë. Hyu Zot është Dashuri dhe Gëzim, i cili në Jezu Krishtin erdhi në botë. Për Kërshendella vjen Gëzimi tek ne. Gëzimi ka shumë emra: Dashuria, Besimi, Miqësia, Shpresa, Mikpritja, Mirëkuptimi, Falja, Falenderimi..., Parajsa. Për Kërshendella Gëzimi ka vetëm një emër: **JEZU KRISHTI**. Urojmë që Foshnja hyjnore Jezu Krishti sërish në çdo zemër të lexuesve dhe të besimtarëve tanë me gëzim të kremton ditëlindjen e vet!

**HIR, PAQE DHE BEKIM PËR FESTËN E KËRSHENDELLAVE**

Redaksia



## POROSIA E IMZOT MARK SOPIT PËR KËRSHENDELLA

*Mos kini frikë! Ja, unë po ju sjell një lajm të mirë: gëzim të madh për mbarë popullin! Sot, në qytet të Davidit ju lindi Shëlbuesi Krishti Zot (Lk 2, 10-11)*

Vëllezër e motra, besimtarë të dashur!

Lajmi më kumbues, më i mirë dhe më i rëndësishëm në historinë e njerëzimit ishte dhe mbetet lajmi mbi lindjen e Jezu Krishtit. Engjëlli i Zotit u lajmëron barinjëve: *Mos kini frikë! Unë po ju sjell një lajm të mirë, gëzim të madh për mbarë popullin...* Janë këto fjalët e gëzueshme dhe shpresëplote, sepse përmes tyre shpallet mishërimi i Birit të Zotit për shëlbimin e botës.

Kjo ngjarje e mrekullueshme përkujtohet dhe kremtohet çdo vit në këtë kohë me gëzim të madh në mbarë botën e krishterë. Nata e shenjtë e Krishtlindjes, por edhe ditët e ardhshme të kësaj kohe të shenjtë, janë ditë të veçanta kur gëzimin tonë ia shprehim njëri-tjetrit me dëshirat më të përzemërta për një mirëqenie më të mirë, më të lumtur, më të begatshme dhe më të qetë.

Lindja e Jezu Krishtit është premtimi i realizuar i Zotit. Ky përkujtim është një përtrirje e vazhdueshme e mirësisë së Zotit që përforcon, ushqen dhe përtërinë fenë e besimtarëve.

Krishti është Zot. Këtë e kanë

paralajmëruar profetët në Besëlidhjen e Vjetër duke paralajmëruar edhe kohën dhe vendin e lindjes së tij. Mikea profet thotë: *E ti, Betlehem Efratë, i vogël ndër qytetet princërore të Judës, prej teje do të dalë ai që do ta sundoj Izraelin... Ai do të ngritet, do të udhëheqë me fuqinë e Zotit, me madhërinë e emrit të Zotit, Hyjit të vet... Ai vetë do të jetë paqja!* (Mik 5, 1a.3.4).

Krishti, Shpëtimtar i botës Mbret i paqes dhe i drejtësisë, është një realitet historik. Me lindjen e tij filloi një epokë e re, e cila do të shënohet me Ligjin e dashurisë. Përmes tij mësuam se Zoti është Dashuri, Babë i mirë, i cili falë, dhe e don njeriun. Te shën Gjoni Ungjilltar lexojmë: *Në fillim ishte Fjala, e Fjala ishte në Hyjin e Fjala ishte Hyj* (Gjn 1, 1). *E Fjala u bë njeri e banoi ndër ne* (Gjn 1, 14)

Në personin e Krishtit gjen arsyen dhe kuptimin e vet jeta e cila është dhuratë e Zotit. Besimi në Krishtin nuk e turpëron askënd. Përkundrazi, kanë mbetur të turpëruar ata që tentuan ta mohojnë ekzistimin e tij. Nuk është e mundur që i tërë njerëzimi t'i përqëndrojë ngjarjet e veta reale rreth një personi ireal. Autenticiteti i Ungjijve, letërsia botërore, arti dhe shumë veprime tjera në botë, nuk u lënë vend aspak dyshimeve të tilla, përkundrazi na thërrasin që përherë ta lëvdojmë emrin e Zotit...

Lindja e Krishtit për besimtarë është festë gëzimi, sepse Biri i Zotit lind i mishëruar në krahërorin e Virgjërës Mari, bëhet i ngjajshëm me ne në të gjitha, përveç mëkatit. Lind në këtë botë që të jetë pranë nesh, dhe me ne, si vëlla, mik, pajtues dhe shëlbuesi ynë...

Kjo ngjarje e madhe dhe e mrekullueshme, na kujton dashurinë dhe kujdesin e Zotit për njeriun, për mbarë njerëzimin. Pjesë e këtyre jemi edhe ne si individ dhe si popull. Ndaj nesh e ka treguar dashurinë e vet në mënyra dhe kohë të ndryshme, e në veçanti në kohët e rëndësishme dhe vendimtare për ne. Ngjarja e Kërshëndellave në mënyrë analoge mund të krahasohet me ngjarjen tonë. Lindja e një realiteti të ri e të dëshiruar me shekuj, lirimi nga robëritë në liri. Në këtë moment vendimtar duhet bashkuar të gjitha fuqitë tona. Në këto ditë të gëzueshme të bashkohemi në falënderim Zotit për të gjithë, duke lutur për paqe, mirëkuptim dhe dashuri mes njerëzve. Është detyrë e jona që të lutemi për udhëheqësit, përfaqësuesit tanë, që Zoti t'i forcojë dhe t'i shndritë për të marrë vendime të mira dhe të drejta që të na sjellin mirëkuptim, tolerancë, paqe e dashuri mes njerëzve.

Me këtë rast, nuk mund të mos e kujtojmë obligimin tonë ndaj bijës sonë të madhe Nënë Terezës. Ajo, me veprën e vet humane, na

afirmoj para mbarë botës. E lartësoj popullin e vet me virtytet e veta njerëzore dhe hyjnore. Është shprehur dëshira jonë në raste dhe mënyra të ndryshme që ta kemi në mesin tonë. Këtë mund ta realizojmë me detyrën që ia kemi vu vetit, ngritjen e katedrales së saj në Prishtinë. Hapat nismëtarë janë bërë, tani lypset vazhduar.

Prandaj, ju ftoj të gjithëve të bashkohemi në lutje edhe për këtë qëllim, për ta realizuar këtë projekt. Kontributet tuaja janë më se të nevojshëm. Nuk dyshojmë se idealet tuaja për gjëra madhore siç u treguan në të kaluarën, nuk do të mungojnë edhe tani për këtë qëllim. Me realizimin e projektit në fjalë, në vitin 2010, njëqindvjetori i lindjes së Nënë Terezës, kemi shpresë të madhe ta kemi edhe Atin e Shenjtë, Papën në mesin tonë. Tani të gjitha janë para nesh, dhe realizimi i tyre varet prej nesh.

Lusim Krishtin Zot për këto qëllime të mira. E lusim dhe urojmë që Ai të largoj çdo urrejtje, vështirësi dhe pikëllim duke i zëvendësuar me mirësi, mirëkuptim, paqe dhe dashuri.

Viti i Ri na gëzoftë me përfundimin fatlum të proceseve të filluara: Kosova shtet sovran dhe i barabartë me shtetet tjera. Poashtu urojmë vazhdim të mbarë e të mirë të fillimit të katedrales Nënë Tereza në Prishtinë.

Për shumë mot e me gëzim Kërshëndellat, urime për një Vit të Ri, të lumtur dhe frytëdhënës.

Mons Mark Sopi, ipeshkëv

## GRAZHDI I BETLEHEMIT

### Pika ku takohet Qielli dhe toka

Një lindje u bë pikënisje e numërimit të viteve të civilizimit tonë, kufiri i historisë para dhe pas erës. Me një fjalë nga lindja e Krishtit i numërojmë vitet si sot. Edhe pse kjo kremte e Kërshëndellave fillon nga shekulli i IV përkatësisht më 25 dhjetor.

Kërshëndellat nuk janë asgjë tjetër përveçse lindja e Jezu Krishtit nga Virgjëra Mari, i cili lindi si çdo njeri, erdhi në këtë botë për të sjellë mirësinë, përvujtërinë, lirinë, sigurinë, dashurinë, shpresën dhe jetën me begati, me një fjalë është festa e jetës. Prej kur Jezusi mishërohet e bëhet nga Zot i vërtetë edhe njeri i vërtetë, në pamjen e fëmijës së *Betleheimit* pikërisht në grazhdin e *betleheimit*, pika ku takohen për herë të parë Qielli dhe toka. Ashtu njeriut nuk i duhet më të ngritet në Qiell për ta takuar Zotin, sepse Zoti zbriti nga Qielli në tokë për t'u takuar me të. Zoti ynë nuk është Zoti i filozofëve, i teologëve, Zoti i lartë dhe i pakapshëm, por ai është Emanuel - *Zoti me ne*, duhet të mësohemi t'i hapim sytë për ta parë në jetën e përditshme! Prej kur ka ardhur Jezu Krishti bota nuk është më e mallkuar, e përjashtuar, e pakuptimtë dhe në Jezu Krishtin e merr kuptimin vuajtja (kryqi). Jezusi është fryti i dashurisë, i paqes, i sigurisë, i suksesit, i lirisë, i përgjegjësisë. Lindi për këtë arsye që njeriu si i tillë të dalë jashtë zinxhirëve djallëzore në jetën e re, në jetën e fisnikëruar, në jetën e dritës dhe të perspektivës, në jetën e dashurisë dhe solidaritetit, në jetën e realizimit të njeriut si njeri.

Kërshëndellat na përkujtojnë idilinë tonë të fëmijërisë të gërshetuar me traditat e llojllojshme. Zgjojnë në ne një ndjenjë fëmijërore. Si fjala bie stoliset bredhi, rregullohet *betleheimi*, ndizen dritëzat, si dhe rituali i *buzmit* etj. Presim dhurata të llojllojshme e shumë e shumë rituale të tjera që ndërliken me festën e Kërshëndellave.

Sipas Paul Claudel: *Fëmija i përhershëm i Zotit*

*është Hyji i gjithëpushtetshëm të cilin e takojmë në fëmijën e grazhdit për të cilin nuk kishte bujtinë. Pikërisht ky fëmijë është ajo feja e gjallë për të cilën flet Gjoni: E fjala u bë njeri e banoi ndër ne... (Gjn 1,14).*

Kërshëndellat përkatësisht Krishtlindja është dita ku Biri i Zotit mishërohet bëhet fëmijë dhe lindi nga virgjëra Mari. Këtë fshehtësi e paraqet Gjoni ungjilltar në fillim të ungjillit: "*E Fjala u bë njeri e banoi ndër ne*". Për mendësinë greke *sarks* nuk është asgjë tjetër përveçse njeriu i mishit, i dejve dhe i eshtrave. Për këtë arsye në mitologjinë greke perënditë nuk ishin nga *sarx-i* (sarks) por vetëm prej *nous*, që do të thotë janë prej mendjes dhe shpirtit. Kurse Gjoni ungjilltar e ndërlihd të pamundshmen për mendjen e njeriut *Fjalën /Logos/ me*



*mishin /sarks/*. Urtia e përrjetshme e Hyjit që është në Fjalën e tij që nga fillimi në Hyjin. Ajo mishërohet nëpërmes Birit të Zotit, edhe sot e kësaj dite bëhet njeri, bëhet një si ne, mw përjashtim të mëkatit, ku e merr natyrën tonë njerëzore, që edhe ne bijtë e njeriut, të jemi vëllezër dhe motra mes veti, një familje e planetit blu të hyjnueshëm. Në këtë gjë fshihet fshehtësia dhe porosia e Kërshëndellave, ku i bëhet ftesa njeriut që të marrë pjesë në jetën e Zotit. Sepse *Fjala* (Logos) nuk është vetëm *Fjalë* por edhe *Qëllim*. Ajo ia jep kuptimin dhe domethënien ekzistencës së njeriut, dhe tregon vlerat e tij. Është një ndërrim i mrekullueshëm (admirabile commercium) për të cilin flet liturgjia e Kërshëndellave. Ati e dhuron Birin si dhuratë. Psalmi 50 pohon se Hyji dhurohet nëpërmes krijesave: “*Më nderon ai që më kushton flinë e lavdit, do t’ia tregoj shpëtimin e Hyjit atij që ecën udhës së drejtë*” (Ps 50,23), po ashtu e shpjegon psalmi në vazhdim: “*Flia e vërtetë për Hyjin: shpirti i penduar, ti, o Hyj, nuk e përbuz zemrën e penduar, të thërrmuar!*” (Ps 51,19).

Asnjë dhuratë nuk është aq e vlefshme po qe se nuk dhurohet nga zemra, që dhuron vetveten. Këtu qëndron porosia e grazhdit të *betlehemit*. Si thotë Koncili i Dytë i Vatikanit: *Misteri i njeriut bëhet i qartë vetëm në mishërimin e Fjalës ... Jezu Krishtin, Adamin e ri* (GS 22). Sepse Adami i vjetër e humbi miqësinë me Hyjin - Krijuesin e vet kur ngritet në kryengritje kundër Hyjit, e ky zë edhe sot e kësaj dite gërthet në çdonjërin prej nesh (Zan 3).

Sipas këndvështrimit të krishterë Hyji në Kopshtin e parajsës premtan se do ta dhurojë *Adamin e ri*, Mesia Emanuel që do të thotë *Zoti me ne* Jezu Krishti, i cili vjen dhe mishërohet në kohën e caktuar historike, që ne sot e kremtojmë me datën 25 dhjetor, dhe e quajmë në gjuhën shqipe

Kërshëndellat ose Krishtlindja.

Sipas Mateut dhe Lukës, Jezusi lindi si *Drita e Zotit* në Betlehem. Po ashtu edhe shën Pali tërthorazi e ndërlidh me qytetin e Davidit, që është Betlehemi. Tradita e lashtë e krishterë pohon vendlindjen e Jezusit, Betlehemin, përkatësisht shpellën. Shën Justini martir (i lindur 100 vjet pas Krishtit në Palestinë) shkruan se Jezusi ishte i lindur në shpellë sepse nuk kishte bujtinë në Betlehem. Në kohën e Adrianit Cezar pas dështimit të kryengritjes së hebrenjve në krye me Bar Kohin rreth vitit 135 e sjell Cezari kultin e Adonisit në Betlehem. Ndërsa Origeni në shekullin e III-të shkruan: *Edhe paganët tregojnë shpellën në të cilën ka lindur Jezusi, të cilin e adhurojnë të krishterët*. Gjithashtu edhe Euzebi (shekulli IV) dëshmon se si Jezusi ka lindur në Betlehem dhe si vendorët e këtij qyteti iu tregojnë të huajve shpellën ku ka lindur Jezusi. Po ashtu edhe shën Jeronimi (iliro-shqiptar) i cili ka qëndruar për shumë vite në Betlehem shkruan: *Shpellën në të cilën dikur ka lindur dhe qarë Jezusi foshnje për të parën herë*.

Kurse Konstatini i Madh pasi bëhet i krishterë vendos që gjatë vitit 326 ta ndërtojë kishën me iniciativën e nënës së tij Helenës për ta ruajtur kujtimin e lindjes së Jezusit në Betlehem. Vërtetë Konstatini e ndërtoi një bazilikë të mrekullueshme dhe të madhe. Gjatë kryengritjes së samaritanëve në shekullin e VI, bazilika ishte e dëmtuar, por Justiniani i Madh në v. 530 e riparoi. Edhe sot e kësaj dite është kjo bazilikë në Jerusalem dhe bartë me vete vulën e Konstantinit dhe Justinianit (të dy nga hapësira e Dardanisë së dikurshme). Ndërsa Luka ungjilltar shkruan: *Sot, në qytet të Davidit ju lindi Shëlbuesi Krishti Zot! Dhe, ja shenja për ta njohur: do ta gjeni një foshnje të mbështjellë me shpërgënj të vënë në grazhd* (Lk 2, 11-12).

*Grazhdi i Betlehemit* (katalyma) është një fakt i pamohueshëm: se Maria dhe Jozefi nuk gjejnë bujtinë. Jezusi lind jashtë qytetit, jashtë banimit njerëzor, kjo familje ishte e detyruar të kërkojë vend për strehim jashtë qytetit, jashtë shoqërisë njerëzore. Në mënyrë figurative e paraqet fatin dhe misionin e Jezusit. Nuk duhet të harrohet se Zoti lind në shpellë, në periferi të shoqërisë, në anonimitet por në ngrohtësinë e familjes. Nga kjo mund të konstatojmë se Shpëtimi i botës nuk vjen nga oborri i ngrohtë mbretëror i stolisur me ar e argjend, por nga shtresa më e ultë njerëzore, përkatësisht në një shpellë të një periferie të qytetit, por dëshmohet solidariteti nëpërmjet vuajtjeve, mundimeve, lotëve si dhe ftohtësive të llojllojshme. Lind nga dashuria ndaj njerëzimit. Ashtu ballafaqohemi me Njeriun e ri (Adami i ri) që përfaqëson kohën e re (epoka e re), epokën e krishterë, që e ka zanafillën në një shpellë përkatësisht *grazhd* por në intimitetin e dashurisë. Nga kjo porosi del shkëndija e shpresës, e gëzimit, e haresë, e takimit dhe mirëkuptimit ndërnjerëzor, por kjo është e mbështetur në ngrohtësinë familjare dhe në dashurinë e mirëfilltë. Fillon nga njerëzit e vegjël, njerëzit e thjeshtë duke u realizuar në ngjarjet e vogla, të cilën e njohin dhe e rinjohin në thjeshtësinë e zemrës. Barinjte ishin të parët që iu shpall porosia e Kërshëndellave, ardhja e Shpëtimtarit (Shëlbuesit). Ata e njohin Shëlbuesin nëpërmjet shenjave që iu jepen: *do të gjeni një foshnje të mbështjellë me shpërgënjë e të vënë në grazhd*. Çfarë logjike paradoksale: Foshnja është shenja, kurse barinjte dëshmitarët e kësaj shenje! Si të parët ashtu edhe i dyti janë të panjohur dhe të paaftë!

Në fund të fundit krishterimi lind nga *grazhdi* i një shpelle, shenja autentike e njohjes është Foshnja, dhe dëshmitarët e kësaj shenje janë barinjte. Në shikimin e parë na duket ky pohim i vogël dhe pa perspektivë, por Hyji qëndron prapa

Foshnjës. Atëherë nuk mund të jetë diçka e vogël. Me fjalë të tjera pas ndodhive të Kërshëndellave qëndron vetë Hyji. Për këtë janë Kërshëndellat shenjë e së ardhmes së re për njerëzit e vegjël, për njerëzit e thjeshtë, për njerëzit zemërmirë, për të shkelurit, për të përbuzurit, për ata që janë të përjashtuar nga shoqëria njerëzore: *Lavdi Hyjit në më të lartin qiell e paqe mbi tokë njerëzve, që i ka për zemër!* (Lk 2,14). Hyji zbulohet si dashuri, që dobësive nuk i turpërohet; është vetë dashuria që pranon edhe dobësinë; në dashuri është gjithëpushtetësia e tij, dashuria që nuk ka kufij. Siç thotë papa Luani i Madh: *Lindja e Krishtit i hap popullit të krishterë dyert, që nuk është asgjë tjetër veçse lindja e Kokës është gjithashtu edhe lindja e trupit*.

Duke e shoqëruar lindjen e fëmijës së Zotit, në të cilën zbulohet dashuria e Zotit ndaj nesh, edhe neve na nxitë për ta krijuar njeriun e ri, i cili do ta eliminojë hijen e vdekjes duke shpallur lajmin e gëzueshëm, si dhe paqen.

Kërshëndellat janë festa e dashurisë, dashuria e vërtetë ndaj njeriut, festa e jetës. Ftesa është në neve. Nganjëherë ndihemi se nuk kemi nevojë për tjetrin ashtu si edhe tjetri për neve, që dikë ta bëjmë të lumtur, ta gëzojmë së paku me një buzëqeshje. Urimi më i sinqertë është shtrëngimi i dorës, letra, biseda telefonike, kujdesi i vogël, dhurata e vogël, urata, kujtimet e bukura të së kaluarës, ndihmë në nevojë dhe shumë e shumë të tjera. Të gjitha i kemi në disponim, që ta bëjmë botën më të bukur, më të njerëzishme, më të gëzueshme. Atëherë mund të themi me gojën plot Për shumë mot Kërshëndellat. Jo vetëm që e gëzojmë tjetrin me ndonjë vepër të mirë por do ta zbulojmë, se edhe ne jemi të lumtur, të gëzueshëm si dhe të realizuar në idealet tona.

**Don Nosh GJOLAJ SDB**

## BOTA PARA ARDHJËS SË KRISHTIT

Shumë herët, që në fillim, u ndërpre rruga kah Hyu me mëkatin e errët. Rrugët e gabuara u degëzuan larg e gjithnjë e më larg. Në fund para syve u zhdruk edhe drita, e cila që nga fillimi ishte në botën e Hyut, atëherë u bë krejt natë dhe në hijen e vdekjes përfundonte rruga në humnerën e e iluzionit dhe të marrëzisë. *Lippert*.

- Një i sëmurë rëndë ishte shtrirë mbi sipërfaqe të gjërë të Tokës. Ky i sëmurë rëndë ishte njerëzimi. *Shën Augustini*.

- Ecja e mëkatit me njerëzimin: KAINI (smira, xhelozia, urrejtja, vrasja. Kaini e vret vëllaun e vet Abelin).

- Përmbytja me ujë (prishja e gjithëmbarrshme e njerëzimit).

- Kulla e Babelit (madhështia, krenaria, egoizmi).

- Shoh të mirën dhe më pëlqen, por prap e bëj të keqën. *Ovidi*.

- Ishte mbrëmje kur erdhi Krishti, sepse tërë bota qëndronte në errësirë. *Shën Ambrozi*.

### Kanë thënë për Mesinë Krishtin

- Do të vijë një Shenjt nga qielli i cili i di të gjitha gjërat dhe do ta merr tërë fuqinë në qiell dhe në tokë. *Konfuçi*, dijetar kinez.

- Duhet të presim derisa të vijë dikush, i cili do të na mësojë si duhet të jetojmë. *Platoni*, filozof grek.

- Ngjarjet nga jeta e Sokratit, mbi të cilat askush nuk dyshon, janë shumë më pak të argumentuara se sa veprat e Krishtit. *Rousseau*, filozof francez.

- Jezu Krishti është fjala më e lartë në histori. Ai është çelësi dhe shpallja e historisë. *Lacordaire*.

- Pitagora, Epikuri, Sokrati, Platoni, janë pishtarë. Krishti është Dita. *V Hygo*.

- Kultura dhe arti evropian nuk mund te kuptohen pa Krishtin. *Dostojevski*

### A e dini se...

- Në v 752 pas themelimit të Romës, në v 42 të sundimit të perandorit Oktavian Augustit, në v. 33 të sundimit të mbretit Herod kur në tërë lëmshin tokësorë mbretëronte qetësia në BETLEHEM të Judës u lind Jezu Krishti, Biri Hyut, i cili me ardhjen e vet desh i ta shenjtërojë botën

- Betlehemin e parë për të ilustruar lindjen e Krishtit e punoi shën Frani i Asizit më 1223.

- Emri Emanuell dmth Zoti me ne.

- Jezu dmth Zoti shpëton.

- Krisht dmth i Shuguruar.

- Mesi dmth Shëlbues

- Eli dmth Jahve është Zoti im.

- David dmth I zgjedhuri.

- Salomon dmth Paqëdashës.

- Timote dmth Lavdi Zotit.

- Elishah dmth Zoti është shpëtimi im.

- Ezekiel dmth Fuqia e Zotit.

- Jeremia dmth Lartësia e Zotit.

- Daniel dmth Gjyqi i Zotit.

- Gjon dmth I bekuari i Zotit.

- Barnaba dmth Biri i ngushëllimit.

## SHËN SHTJEFNI - MARTIRI I PARË I KISHËS

(26 dhjetor)

Krejt çka dijmë për jetën e tij është Shkrimi shenjt. Por as aty nuk gjëjmë detaje nga jeta e tij si psh kur ka lindur, ku etj. Por kjo para Zotit dhe për autorët e Shkrimit shenjt nuk ka rëndësi. Sepse më e rëndësishme është ajo që Shkrimi shenjt dëshmon për Shtjefnin. Pra, në Bibël lexojmë për jetën, vuatjen dhe vdekjen e tij martire.

Pas Rrëshajve dhe ardhjes së Shpirtit Shenjt, apostujt pa lodhshëm predikonin ungjillin. Me rritjen e besimtarëve, rriteshin edhe obligimet dhe përgjegjësitë rreth ndarjes së ndihmave. Disa të varfër dhe të veja u ankuan se gjatë ndarjes së ushqimit atyre po iu bëhet e padrejtë. Andaj apostujt vendosen që të zgjedhin disa burra që do të kujdesohen për këto gjëra, ndërsa apostujt do ta predikojnë Ungjillin. Dhe në mesin e tyre...*ata zgjedhën Shtjefnin, njeri plot fe e Shpirt Shenjt* (Vap 6, 5). *Ndërkaq, Shtjefni, që ishte plot hir dhe fuqi, bënte mrekulli dhe shenja të mëdha në popull* (Vap 6,7). Pra, kjo dëshmon se shën Shtjefni ishte njeri i kushtuar Zotit dhe shërbimit ndaj nevojtarëve. Edhe pse ai nuk e kishte detyrë kryesore predikimin si apostujt, ai këtë e bënte me shumë sukses (Vap 6,7 7,60). Pra, pasi që ata që e vranë edhe Krishtin, duke e paditur rrejtshëm para Pilatit, nuk arriten ta kundërshtojnë mesazhin e Shtjefnit, e paditen rrejtshëm. Por, Shtjefni plot me Shpirt Shenjt nuk u frikësua fare nga ata, që siq thotë *Krishti e vrasin trupin, por jo edhe shpirtin. Bashkëkombasit e vet, nga urrejtja, të vërbuar në shpirt e vrasin Shtjefnin me*

gurë. Por, Ai as në këto momente nuk ndjen urrejtje ndaj armiqëve të vet. Duke e ndjekur shembullin e Krishtit, Shtjefni edhe në momentet e fundit lutet: *O Jezus Zot, merre shpirtin tim...O Zot, mos ua merr këtë për mëkat!* (Vap 7,9).

Pra, shën Shtjefni i pari me fjalë, vepra dhe me vdekjen e vet martire e dëshmoi besnikërinë dhe dashurinë ndaj Krishtit. Dje kemi festuar Lindjen e Krishtit me plot gëzim. Sot përkujtojmë vdekjen e martirit të parë. Pse ky kontraste? Dje festë gëzimi, sot pikëllim, vdekje? Kisha dëshiron të na bëjë me dije se jeta jonë nuk përbehet vetëm prej gëzimeve, por edhe prej vuatjeve. Me fjalë të tjera mund të themi se nuk ka Krishtlindje pa kryq, gjegjësisht pa Pashkë.

Shën Shtjefni që e pa qiellin e hapur na nxitë të ecim gjurmëve të tij. Bashkë me të dhe shën Palin, që ishte dëshmitar i vdekjes së tij (shih Vap 8, 1) le të themi: As jeta as vdekja, as e tashmja, as e ardhmja, as ngushtica, as salvimi...asgjë nuk do të na ndajë nga Krishti. Urime Dita e emrit atyre që e bartin emrin e këtij shenjt.

*Shën Shtjefni lutu për ne!*

Don Kolë **ZEFI**



## FESTA E FËMIJËVE TË PAFAJSHËM (28 dhjetor)

Koha e Krishtlindjes është e përshkuar nga Lajmi i gëzueshëm për lindjen e Mesisë Shëlbuesit të botës. Në vazhden e festave të Krishtlindjes, Kisha përkujton edhe festën e Fëmijëve të Pafajshëm. Kjo festë na përkujton ngjarjen e dhimbshme dhe tragjike e cila ndodhi pak kohë pas lindjes së Jezu Krishtit në Betlehemin e Judesë.

Jezu Krishti lindi në kohën e mbretit Herod. Në pyetjen e Dijetarëve *ku është foshnja e lindur që do të bëhet mbreti i judenjëve* ai shqetësohet shumë. Kështu zë fill në zemrën e tij urrejtja ndaj çdokujt që do të mund të quhej mbret. Pra, filloi të pyesë për vendin dhe kohën e lindjes së kësaj foshnje me qëllim që ta vrasë dhe kështu të eliminojë çdokënd që do t'ia rrezikonte pushtetin e tij. Dijetarët, të mësuar në ëndërr prej Hyjit që të mos kthehen prapë te Herodi e ta lajmërojnë për vendin e lindjes së Jezu Krishtit, kthehen një rrugë tjetër në vendin e vet. Kjo shkaktoi zemërim të madh tek Herodi, dhe në Ungjillin e shën Mateut lexojmë: *Atëherë Herodi, kur pa se e mashtruan Dijetarët, u zemërua për së tepërmi dhe urdhëroi të vriten të gjithë fëmijët meshkuj që ishin në Betlehem dhe në mbarë rrethinën e tij dy vjeç e poshtë sipas kohës që me kujdes e hetoi nga Dijetarët.* (Mt 2, 16).

Si mund të shpjegohet kjo vepër aq e rëndë e një mbreti që është vrasës i qytetarëve të vet? Përgjithësisht mëkati është burimi i së keqes. Përderisa njeriu jeton në mëkat ai jeton në errësirë dhe nuk mund ta shohë dritën. Kjo ndodhë me mbretin Herod të cilin mund ta identifikojmë si mendjelahtë, egoist, lakmues, dashakeq i cili urdhëroi një krim aq të madh.

Festa e Fëmijëve të Pafajshëm, disi, në moment na duket sikur është zbehur atmosfera e gëzimit për lindjen e Krishtit, sepse kjo ngjarje do ta ketë tronditur mbarë njerëzimin. Le ta krahasojmë pak lajmin e Gëzueshëm të Engjëllit Gabriel me fjalët e Jeremisë profet. Engjëlli i Zotit thotë: *Mos kini frikë! Ja, unë po ju sjell një lajm të mirë: gëzim të madh për mbarë popullin! Sot, në qytet të Davidit ju lindi Shëlbuesi Krishti Zot!* (Lk 2, 10-11); ndërsa, Jeremia profet shkruan: *U dëgjua një klithmë në Ramë vaj e gjëmë e madhe: vajton Rakela*

*fëmijët e vet e nuk do të pajtohet sepse nuk i ka më!* (Mt 2, 17-18).

Gjithësesi, vrasja e Fëmijëve të Pafajshëm është një krim i madh i mbretit Herod të cilin historia do ta kujtoj përherë si mbret të keq. Fëmijët e pafajshëm, njëherit janë dëshmitarët apo martirët e parë të Krishtit. Prandaj, edhe vdekja apo martirizimi i tyre, në Krishtin e gjen kuptimin e vet. Kështu pra, asnjë ngjarje apo edhe rast i dhimbshëm e tragjik nuk guxon ta zbehë gëzimin për lindjen e Krishtit, sepse lindja e tij është një fillim i jetës së re për çdo njeri vullnetmirë.

Ne duhet të shqetësohemi e të brengosemi për faktin se edhe sot vriten shumë fëmijë të pafajshëm. Fatkeqësisht, edhe në vendin tonë është në rritje numri i abortimeve. Njerëzit sot nuk dëshirojnë të ballafaqohen me të vërtetën dhe problemet reale. Në vend se të pranohet gabimi ata mundohen të arsyetohen me qëllim që ta qetësojnë ndërgjegjen e vet. Duhet shtruar pyetjen se sa është kuptuar urdhëri i pestë i Zotit: *Mos vra!*

Jeta e njeriut është vepër e Zotit dhe njëherit ajo është e shenjtë. Prandaj prindërit, ata të cilët janë të ftuar të bëhen bartës të jetës, nuk duhet t'i lejojnë vehtes të bëhen vrasës të familjes, shoqërisë, popullit dhe të ardhmes së vet. Pra, ju prindër, me ndihmën e Zotit jeni jetëdhënës e jo varr i fëmijëve tuaj!

Mjerisht, ka të tillë që nuk hezitojnë të bashkëpunojnë në mënyrë direkte apo indirekte në kryerjen e këtyre vrasjeve. A e pyesin veten ata njerëz, sikur të kishte qenë jeta e tyre në duar të *Herodëve të tillë*, ku do të ishin ata sot?!

I lutemi Zotit që të na lirojë nga *Herodët* e sotshëm *modern*, të cilët angazhohen për aprovimin e ligjeve me të cilat do të legalizohet vrasja e të pafajshmëve.

Festa e fëmijëve të pafajshëm është një rast i mirë që të mendojmë mbi të gjitha dukuritë e këqija të cilat e dëmtojnë jetën shpirtërore si dhe atë fizike. E lusim Zotin edhe për të gjithë ata fëmijë që janë jetimë, ata që jetojnë në vuajtje, skllavëri, të angazhuar në punë të rënda fizike, që Zoti të jetë ndihma e tyre drejt një të ardhme më të mirë. Amen.

Don Agim QERKINI

## FAMILJA SHENJTE BURIM I LUMTURISË PËR FAMILJET TONA

Gazeta kroate *Lajmëtari* i të mërkures i dt 26.VIII.1959, botoi një letër me titull *Ditëlindja e nënës*. Letra ka këtë përmbajtje: *E kam patur nënën, ka qenë e mirë dhe e bukur. Por një ditë e humba...?! Ajo shkoi, e vëllaun tim më të vogël dhe mua na la me babën. Kur përnjëmend e kuptova shkuarjen e saj qajta shumë. Por ajo nuk deshi të dijë për lotët dhe vuajtjet tona. Ajo e deshi dikënd tjetër, më shumë se ne!?! Kaloi një vitë pa të, por megjithatë unë e di se në këtë muaj ajo e ka ditëlindjen. Se ku është tash nuk di, a është e lumtur nuk e di? Por megjithatë, unë e kujtoj me mall dhe dashuri nënën time, edhe pse e di se nuk do të kthehet. Redaktor i dashur, të lutem shumë, që në një kënd të gazetës suaj, nëse ka vend të lirë të botoni këta pak rreshta, me shpresë se do t'i lexojë edhe nëna ime. Pasiqë e di se ajo rregullisht e lexon*

*gazetën tuaj. E di se bashkë me këta rreshta është dashur t'iu dërgoj edhe paratë, por unë ato nuk i kam. Babai im nuk e di për këtë veprim timin. Dëshira ime është t'ia bëj me dije nënës sime se ne atë e duam dhe se ende nuk e kemi harruar...*

Në këtë letër në mënyrë aq të sinqertë është shprehur dhimbja, vuajtja e shpirtit të fëmiut për nënën. Nëna është shpirti dhe zemra e familjes. Ja edhe një ngjarje tjetër të vërtetë:

*Burri dhe gruaja vendosën të shkurorëzohen. I paraqiten secili arsyet e veta para gjyqtarit. Dhe gjithçka shkoi në rregull derisa nuk erdhi në pyetje fëmiu i tyre: Me kënd do të shkojë djali i tyre i vetëm? Te dy prindërit e dëshironin për veti. Gjykatësi vendosi ta pyet fëmiumin, i tha: Kënd e do më tepër, babin apo mamin? Më kënd dëshiron të shkosh? Vogëlushi i shiqoi njërin dhe tjetrin dhe duke qarë tha: Unë i dua të dytë, dëshirojë të jetojë me të dytë!*

Bashkëshortët para se të ndërmarin një qëndrim të tillë të shkurorëzimit duhet të mendojnë seriozisht për pasojat e një hapi të tillë. Nuk guxojnë të mendojnë vetëm për jetën e vet personale, por edhe për fëmijët, për fatin dhe lumturinë e tyre. Krishti na mëson se vetëm vdekja mund t'i ndajë bashkëshortët. Pra, ndarjen nuk guxon ta shkaktojë as pasuria, e as varfëria, as shëndeti e as sëmundja..., por vetëm vdekja. Të gjitha mosmarrëveshjet me ndihmën e Zotit dhe për hir të fëmijëve duhet të zgjidhen në paqe. Duhet gjetur forcë për të kërkuar falje dhe për të falur njëri tjetrin. Vërtet që nga një herë kjo është e vështirë, por rrugë tjetër nuk ka.



Kush kërkon rrugëdalje tjetër do të pësojë ai dhe familja e tij. Kushti i parë për të qenë familja e lumtur është gatishmëria për të kërkuar falje dhe për të falur. Sepse aty ku njeriu fal, krijon paqe dhe në këtë mënyrë krijohet ambient i qetë, që është i domosdoshëm për rritjen e lumtur të fëmijëve. Familja e përcarë, nuk mund të përparojë, të ketë lumturi. Të gjithë ne si besimtarë duhet të kemi parasysh fjalët e shën Palit: *Ju përbej unë i burgosuri në Zotin, jetoni denjësisht si i ka hije thirrjes që keni marrë, me plot përvujtëri, butësi e duresë, durone njëri tjetrin me dashuri. Bëni çmos ta ruani njësinë e shpirtit me anë të paqes që ju bashkon!*

Sot kremtojmë Familjën më të shenjtë që ka jetuar ndonjëherë në Tokë, e kjo është Familja Shenjte e përbërë prej Jozefit, Marisë dhe Krishtit. Kjo familje ishte e lumtur sepse në qendër të saj ishte vet Krishti. Familja Shenjte duhet të jetë shembull edhe për familjet tona. Le të jetë Krishti në qendër të tyre, atëher pamarrë parasysh gjendjen ekonomike, sociale,

shendetësore, ne do të jemi të lumtur, sepse Krishti është burimi i lumturisë.

Sot është edhe Dita e Mërgimtarëve. Ne kemi shumë familje që për shkaqe të ndryshme kanë ikur në grybet. Le të lusim Familjen Shenjte që t'i ruaj të bashkuara familjet tona, në paqe dhe dashuri, kudo ato qofshin.

Pra, le ta kuptojmë faktin se nëse dëshirojmë ardhmëri të lumtur si Kishë dhe si popull duhet t'i ruajmë të bashkuara dhe të shëndosha familjet tona: Familja është burimi, oaza, qeliza, bërthama e shoqërisë. Në familje të shëndosha, të lumtura lindin dhe rriten qytetarët e mirë dhe të ndershëm. Në familjet e shkatërruara lindin dhe rriten delikventet. Pra, familja duhet të jetë kisha dhe shkolla e parë, ku fëmijët, ardhmëria e jonë, bashkë me hapat e parë të jetës do t'i mësojnë edhe vlerat tona fetare dhe kombëtare që sot neser të jenë krenaria e prindërve të vet si dhe e jona si Kishë dhe si popull. Dhashtë Zoti që ashtu edhe të jetë. Amen.

Don Tomë **KARRICA**

## KRONIKA

**6.XII. Janjevë:** Me solemnitete të madhe u kremtua festa e shën Kollit. Meshën e udhëheqi Atë Stjepan Kushan nga Ohëri.

**6.XII. Kabash:** Shën Kolli u kremtua solemnisht edhe në Kabash. Populli me meshë, predikime dhe rrëfime u përgatit gjatë nëntë ditëve. Meshën ditën e shën Kollit e udhëheqi don Marjan Marku, misionar në Sirnah të Zvicrës.

**17.XII. Prishtinë:** Ditë e madhe dhe e gëzueshme për Prishtinën dhe për Ipeshkvinë tonë. Ipeshkvi ynë Mons Mark Sopi, rendin e xhakonatit iu ndau dy vëllëzërve bineç Robert dhe Albert Jakaj. Duke iu uruar këtë detyrë xhakonave të rinjë, dëshirojmë që sa më parë të marrin edhe rendin e meshtarisë, e kështu të punojnë pa lodhshëm në Vreshtin e Hyjit.

## POROSIA E PAPËS PËR DITËN NDËRKOMBËTARE TË PAQËS



Në paqe është e vërteta është titulli i porosisë së parë të papës Benediktit të XVI me rastin e Ditës ndërkombëtare të paqës, që u publikua në Vatikan më 13.XII. Në qendër të kësaj porosie, siç vërejtjti kardinal Martini, i cili e bëri prezantimin e saj, Papa e ka theksuar të vërtetën, duke i sintetizuar dimenisonet e ndryshme të saj me pyetjet e ndryshme që lidhën me paqën në botën e sotme.

Papa, vëren se paqja nuk arrihet duke theksuar dallimet personale, gjë që është karakteristikë e nacionalizmit të tepruar që ka qenë dhe është burim i sa e sa konflikteve të përgjakura. Paqja, përkundrazi mbetet projekt i besueshëm dhe i realizueshëm kur vlerësohet ndjenja e përbashkët e përkatësisë sonë familjës së njëjtë njerëzore. Në vazhdim, Papa thekson se paqja nuk konsiston vetëm me faktin e mungesës së luftës, por kërkon realizimn e plotë të individit dhe të popujve.

Papa në porosinë e vet e denonë terrorizmin dhe theksonë se *burimin e tij duhet kërkuar në njërën anë tek nihilizmi, në anën tjetër në fundamentalizmin fanatik. Qendrimi i tyre ndaj të vërtetës, pra ndaj paqës së vërtetë, është plotësisht i gabuar: derisa nihilistët mohojnë çdo ekzistim të vërtetës, fundamentalistët mendojnë që janë të vetmit që e posedojnë të vërtetën. Edhe pse kanë motive dhe manifestime të ndryshme të cilat shfaqën në kontekste të ndryshme kulturore, nihilizmi dhe fundamentalizmi kanë diçka të përbashkët: mospërfilljen apo përbuzjen ndaj njeriut dhe jetës së tij. Në themelet e kësaj pikënjisjes së përbashkët qendronë shtremberimi i të vërtetës së plotë mbi Zotin: nihilizmi e mohonë ekzistimin e Zotit dhe provaninë e Tij në historinë e njerëzimit, ndërsa fundamentalizmi e deformon fytyrën e mëshirshme të Zotit, i cili e do njeriun.*

*E vërteta e paqës, siç thekson Papa, kërkon që të gjithë si qeveritë të cilat moti kohë e kanë armatimin nuklearë dhe qeveritë që mundohen ta kenë një armatim të tillë të hapin një fage të re në politikat e veta dhe të bijnë vendime të qarta dhe vendimtare të drejtuara kah çarmatimi nuklearë. Papa në këtë drejtim vë në dukje faktin se hargjimet rreth armatimit nuklearë dhe armatimit në përgjithësi është në rritje e sipër. Vetëm në v 2004 në këtë drejtim janë shpenzuar tre biljard dollarë, që janë 160 dollarë për çdo banorë të planetit tonë! Çfarë ardhmërie të paqës mund të presim nëse vazhdohet të investohet në prodhimin e armëve dhe krijimin e armëve të reja?, pyetet i shqetësuar papa.*

## VITI I RI DITA E PAQËS

*Paqa na nevojitet në tërë planetin  
Djalli me shqetësime njeriut iu hakmirret.  
Përçarja dhe urrejtja të gjithëve na  
shkatërrojnë  
Djalli në këtë mënyrë ferrin krijonë.*

*Njerëzit me urrejtje shkatërrojnë të tjerët  
Kështu ata bëhen shërbetorë të djallit  
E ne dëshirojmë me t'u lutë o Virgjër,  
Na jep paqën që të gëzohemi.*

Vëllëzër dhe motëra! Me këto vargje drejtuar Nënës qiellore besoj që secili prej nesh dëshiron të hyjë në Vitin e Ri, që më të mos ketë urrejtje, përçarje dhe ndasi, por paqe, shëndet e gëzim. Kjo është edhe kënga apo himni i kësaj kohe të shenjtë të Kërshendellave: ... të gjithëve në tokë paqe dhe gëzim. Po, bash ashtu, të gjithëve, çdo zemrës njerëzore, çdo njeriut.

Edhe ti vëlla dhe motër e dashur je i ftuar të krijosh dhe përhapish PAQEN vëllaut njeri. Nganjëherë mendon se nuk mund të bësh asgjë, që nuk je i rëndësishëm për PAQE. A nuk është kjo ikje nga përgjegjësia? Nuk është frikë dhe mospajtim që ndoshta të tjerët do të përqeshin, përjashtojnë etj? Shiqo rreth vetit! Dëgjo! Do të vëresh se sa të shumë janë ata që kanë nevojë për ty! Do t'i dëgjosh klithjet e shumëta! Këtu tregohu i krishterë, nxënës dhe vëlla i Krishtit. Ai vet na ka thënë dhe ne e pëserisim në çdo meshë: *Paqa me ju!* Pranone dhe përcillne tek të tjerët këtë porosi. Këtë mund ta bësh edhe ti vëlla dhe motër e dashur, mos prit, mos u frikëso dhe mos e le për naser. Pranoje paqen dhe përcille më tutje. Krishti është paqja jonë dhe Maria na e tregon dhe na e dhuron Krishtin. Krishtin e pranojmë me vetëdëshirë. Për këtë arsye Krishti iu sjell paqën atyre që e pranojnë. Njeriu shpesh herë anon që në këtë dëshirë t'i tejkalojë kufijtë dhe mundësitë e veta, dhe kështu të prish paqen. Në këtë lojë është edhe djalli i cili nuk ndalet. Por, Krishti e mundi djallin në të

gjitha tundimet, dhe neve na e le shembullin që vazhdimisht të luftojmë kundër tij nëse duam paqe, gëzim dhe lumturi në zemrat tona. Paqen duhet pranuar dhe ruajtur në bashkëpunim me Paqen dhe Dashurinë e amshuar. Paqen duhet ruajtur edhe në raportë me të afërmit, sepse çdo njëri prej nesh është i krijuar në shembëlltërinë e Zotit. E Krishti na mëson të kemi dashuri ndaj Zotit dhe ndaj të afërmit, Dhe një dashuri e tillë na sjellë paqe, dhe armiku ynë djalli duhet të largohet, natyrisht i turpëruar dhe i mundur.

Për këtë arsye papa i ndjerë Gjon Pali II duke e shpallur *Një Janarin* Ditën ndërkombëtare të paqës theksoi se paqa është vlerë që nuk ka kufij dhe që i nevojitet çdo njeriut vullnet mirë. E vullneti i mirë për rikthesën e jetës duhet të jetë në vet njeriun, i cili në brendinë e vet, familjen dhe rrethin e vet krijon atmosferën e paqes dhe të drejtësisë.

Në fillim të këtij viti të gjithë jemi të ftuar të hyjmë në risinë e paqes së Betlehemit, dhe me Zotin të fillojmë të lexojmë faqet e librit të ri. Jemi të lumtur që kaloj një vitë. Disa ngjarje as që duam t'i kujtojmë, e lëre më të përseriten. Por ka edhe gjëra të mira që i kujtojmë me mall dhe dashuri. Por secili prej nesh duhet të bëj një llogaritje: Kemi bërë më tepër vepra të mira apo të këqia? Kemi bashkëpunuar më tepër me Zotin apo me djallin? Duke mos e harruar faktin se ky vitë për ndonjërin prej nesh mund të jetë viti i fundit i jetës sonë! Përveq tjerash ne, një vitë jemi më të vjetër, dhe natyrisht më afër vdekjes, gjegjësisht amshimit, takimit tonë përfundimtar me Zotin.

Në trojet tona ka pasur shumë trazime, paknaqësi, luftë, vrasje. Unë dhe ti, vëlla dhe motër e dashur, le të bashkohemi me Marinë dhe Jezusin dhe të nisemi së bashku në rrugën e dashurisë, sepse para nesh është Viti i Ri, një kohë e re, një fillim i ri.

Uroj dhe lutem që të jetë fillim i mbarë dhe i lumtur për të gjithë. Amen.

Don Mate **PALIQ**

## PAGËZIMI I ZOTIT

Prej Këshëndellave deri më sot para syve tanë është Betlehemi: shtalla dhe Zoti-njeri foshnja e Marisë mbi kashtë në shpellë. Kisha, liturgjia, ritet, lutjet, këngët të gjitha na flasin: Fjala Zoti - Biri është mishëruar, është bërë njeri, vëllai ynë i madh, mësues, çlirimtar. Vet Ungjilli e vërteton këtë të vërtetë. Festa e Pagëzimit të Jezusit në lumin Jordan është fillimi i veprimtarisë së tij publike, është kthim rrënjësor, sepse që nga tani nuk do të jetë më një zdrukëhtar nga Nazareti, por bëhet *profet*, predikatar i Mbretërisë së qiellit, Mesia.

Kjo festë në një mënyrë është Dëftimi: këtu më nuk lajmërohen as engjëjt, as ylli, por vet Ati qiellor i cili më zërin nga qielli e vërteton Jezu Krishtin për Bir të vetin para masës e cila u gjet te lumi Jordan. Kush, vërtet, është kjo foshnje nga Betlehemi? Këtë e din vetëm qielli i cili hapet, e zëri i Zotit që i shpall tokës misterin dhe të vërtetën më të madhe për Shëlbuesin tonë. Ngjarjen e përcjell edhe një dëshmitar: Shpirti Shenjt, fuqia e Zotit më të cilën Jezusi që nga tani do të flasë *sikur askush më parë që nuk ka folë* dhe do të bënë vepra të mrekullueshme të cilat mund t'i bëjë vetëm Zoti.

Jezusi në Jordan: tridhjetë vite pas lindjes në Betlehem. E la Galilenë dhe vendlindjen Nazaretin, erdhi në Jordan *te Gjoni që ai ta pagëzoi*. Judenjtë kanë pranuar pagëzimin e Gjonit si shenjë dhe dëshmi pendese, kthimi, shenjtërimi. Zotit tonë të gjitha këto nuk ju kanë nevojat: Ai nuk shkon te Jordani që ujërat e Jordanit ta lajnë nga mëkatet ta shenjtërojnë por ai t'i shenjtëronte të gjitha ujërat e botës më të cilat do të pagëzohen miljarda njerëz. Zoti vjen në Jordan që më shembull të na tregonte se çka neve na duhet të bëjmë: të kthehemi, të pendohemi, të ndërrohem, të shenjtërohemi...

Jezusi në Jordan i vetmi njeri i cili nuk ishte mëkatar në mesin e mëkatarëve; merr mbi vete mëkatet e botës që më pendesën e vet, më pagëzimin në Jordan t'i lante nga trupi i njerëzimit; që njëherë t'i zhyt në gjakun e vet në Kalvar: - për atë edhe vdekjen e vet e quan pagëzim. Jezusi në Jordan: - nuk ka pasur nevojë as për pendim e as për kthim, dhe ja në mesin e pendestarëve, pranon pendesën, jeten e mundimshme për ne, në vend tonin: që t'i lehësonte dhe t'i shenjtëronte vuajtjet dhe

kryqet e të gjithë neve; që jetës së njeriut në vuajtje t'i jpte kuptim, vlerë, fuqinë shpëtimprurëse.

Jezusi në Jordan, në lumin e pagëzimit: - zëri dëgjohej nga qielli: *Ky është Biri im i dashur, të cilin e kam për zemër!* Zëri i Zotit i jep Jezusit autorizimin, e përforcon para paraqitjes së tij publike. Tri vite udhtimi, predikimi, atëherë mbarimi: kryqi, varri, ngjallja. Biri i Zotit, të cilin e ka për zemër, erdhi ndër ne që neve të na bënte të dashurit e Zotit. *Ti je biri im, i dashuri im!* Zoti i ka thënë secilit prej nesh në ditën e pagëzimit. Në atë moment kemi fituar biesinë në shpirt. Pagëzimi është fat, por edhe obligim: çdo ditë kthim, çdo ditë të bëhemi sa më të ngajshëm më Zotin. Pagëzimi është porosi: jemi bij dhe bija të Zotit, këtë duhet ta dëshmojmë më jetë

*Tregohet se si një njeri, brenda natës, është bërë i krishterë. Ka besuar, është pagëzuar, dhe ka filluar të vij në meshë, në bankën e parë. Disa me duke dyshuar në sinqeritetin e tij pyesnin: Çfarë i krishtëri je ti kur nuk din Besojmen, as Dhjetë urdhërimet,... Nuk i di, e pranonte i qetë. Qe, as Ati ynë, Të falemi Mari, ... nuk di t'i lutësh pa gabime! i tha njëri. Në bazë të çkahit mund të llogarisim se je i krishterë? e pyten ata që e humbnin durimin. Ai përgjigji: Në bazë të kësaj se më nuk jetoi më jetën e vjeter, jam bërë njeri i ri, më nuk pi, nuk dehem, gruaja dhe fëmijët e mi më nuk më frigohen, nuk ikin nga unë, më presin me gezim kur kthehem nga puna, pasdite dalim së bashku në shetitje, më duan, edhe unë i dua. Nuk ka më ngatërresa, përklarje, bërtimë. Asnjë sharje e madhe kahmoti nuk ka dalur nga goja ime. Ja këtë e ka bërë më mua pagëzimi apo Jezusi, nëse bash doni ta dini. Unë nuk di shumë katekizëm, por një e di: Jezusi e ka ndërruar tërësisht jetën time, kjo është për mua më e madhja dije katekizmi i jetës.*

Të lejojmë që edhe në ne Jezu Krishti, ta ndërroi komplet jetën tonë. Mos të vazhdomjë të jetojmë me jetën e mbrapshtë e të vjeter, por me jetën e re të hirit. Amen

Don Rrok GJONLLESHAJ



PAQE DHE BEKIM  
NË VITIN 2006